



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISE  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 328 datë 9.9.1986

PËR

DISA NDRYSHIME E SHITESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
NR.28, DATË 20.3.1978 "PËR FIROT E MALLRAVE GJATË RUAJTJES,  
TRANSPORTIMIT DHE TREGTIMIT TË TYRE"

Me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes Popullore, të Ministrisë së Energjetikës, të Ministrisë së Tregtisë së Brendshme, të Ministrisë së Komunikacioneve dhe të Drejtorisë së Rezervave Shtetërore, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.28, datë 20.3.1978, bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Në pikën 2, pas paragrafit të katërt, shtohen dy paragrafe me këtë përmbajtje:

"Ferot gjatë ruajtjes, mbushje-zbraxjes dhe transportimit të karburanteve e lubrifikanteve përfshihen në pasqyrën Nr.9, kurse ferot e karburanteve gjatë konservimit në teknikën luftarake dhe shpërndarjes me pakicë gjatë stërvitjeve në terren përfshihen në pasqyrën Nr.10, që i bashkëngjiten këtij vendimi.

Ferot në karburante e lubrifikante që përfshihen në pasqyrat Nr.9 dhe Nr.10, zbatohen për sistemin e Ministrisë së Energjetikës, të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore, të Ministrisë së Komunikacioneve, të Ministrisë së Tregtisë së Brendshme e të Drejtorisë së Rezervave Shtetërore. Në përshtatje me kushtet e tyre, këto ministri të nxjerrin udhëzime për mënyrën e llogaritjes dhe të miratimit të diferencave në

përputhje me firot e lejuara."


2. Komisioni i Planit të Shtetit, në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes Popullore, Ministrinë e Energjetikës, Ministrinë e Tregtisë së Brendshme dhe Drejtorinë e Rezervave Shtetërore, me grup pune, deri në fund të vitit 1990 të paraqesë studimin për uljen e mëtejshme të firove në karburante e lubrifikante dhe, brenda vitit 1987, studimin për masat që duhen marrë për futjen e teknikave të reja, me synim që në pesëvjeçarin e ardhshëm humbjet në benzinë të ulen në masën mbi 30 për qind.

3. Pika 8 e vendimit Nr.28, datë 20.3.1978, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZV.KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

MANUSH MYFTIU



Nr.prot.1728/1

Datë 23.9.1986

MINISTRISË SË MBROJTJES POPULLORE  
 MINISTRISË SË ENERGETIKËS  
 MINISTRISË SË TREGTISË SË BRENDSHME  
 MINISTRISË SË KOMUNIKACIONEVE  
 KOMISIONIT TË PLANIT TË SHTETIT  
 KOMITETIT TË ÇMIMEVE DHE TË STANDARDEVE  
 MINISTRISË SË FINANCAVE  
 DREJTORISË SË REZERVAVE SHTETËRORE  
 MINISTRISË SË NDËRTIMIT  
 MINISTRISË SË PUNEVE TË BRENDSHME  
 MINISTRISË SË BUJQËSISË

T I R A N Ë

KOMITETEVE EKZEKUTIVE TË KP TË RRETHEVE

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

GJON GORISHTI



FIROT GJATË RUAJTJES, MBUSHJE-ZBRAZJES DHE TRANSPORTIMIT  
TË KARBURANTEVE E LUBRIFIKANTEVE

a) Firot gjatë ruajtjes në përqindje të peshës

Nr.	Emërtimi	Përqindja e lejuar e firove vjetore		
		Rezervuar mbitokësor	Rezervuar gjysmë nëntokësor	Rezervuar nëntokësor
1.	Benzinë e të gjitha llojeve, deri.....	1,1	0,4	0,2
2.	Vajguri TS-1, llampan deri.....	0,2	0,1	0,05
3.	Gazoil, solar, deri...	0,08	0,04	0,03

Shënim: a) Koha e ruajtjes për afate të gjata llogaritet nga dita e fillimit të mbushjes deri në zbrazjen e plotë. Sasia, mbi bazën e së cilës llogariten humbjet, merret sasia kontabël e rezervuarit të mbushur.

b) Në rezervuarët ku ka hyrje-dalje gjatë vitit, firoja gjatë ruajtjes llogaritet mbi sasinë mesatare që qëndron gjendje gjatë gjithë kohës në rezervuar dhe jo mbi sasinë që qarkullon.

c) Firot gjatë një cikli të plotë mbushjeje e zbrazjeje rezervuari, boti ose fuçie të çfarëdo lloji, në përqindje të peshës

Nr.	Emërtimi	Përqindja e lejuar e firove			
		Zbrazje boti	Mbushje rezervuari	Zbrazje rezervuari	Mbushje boti
1.	Benzinë e të gjitha llojeve, deri.....	0,2	0,3	0,3	0,3
2.	Vajguri TS-1, llampan, deri.....	0,15	0,2	0,1	0,2
3.	Gazoil e solar, deri...	0,1	0,05	0,1	0,05
4.	Vajra lubrifikante, deri.....	0,15	0,05	0,15	0,05

Shënim: Firot e mbushje-zbrazjeve në një rezervuar llogariten mbi bazën e numrit të cikleve të tyre për një periudhë të caktuar, që del nga raporti i sasisë së karburantit që ka hyrë në rezervuar me aftësinë mbajtëse maksimale të tij.

ç) Firot gjatë transportit hekurudhor dhe automobilistik,  
në përqindje të peshës

<u>E m ë r t i m i :</u>	<u>Përqindja e lejuar mbi sasinë e transportuar</u>
1. Benzinë e vajguri të çfarëdo lloji, deri...	0,1
2. Gazoil, deri.....	0,05

d) Firot gjatë transportit me mjetet detare, në përqindje të peshës mbi sasinë e transportuar

Nr.	E m ë r t i m i :	Mjetet	Firot e lejuara		
			Gjatë transportit	Gjatë mbushjes	Gjatë zbrazjes
1.	Benzinë e të gjitha llojeve, deri.....	Tanker	0,2	0,1	0,1
		mjete të tjera	0,2	0,1	0,1
2.	Vajguri TS-1 etj. deri.....	Tanker	0,1	0,05	0,05
		mjete të tjera	0,1	0,05	0,05
3.	Gazoil e solar, deri..	Tanker	0,1	0,01	0,01
		mjete të tjera	0,1	0,01	0,01

Pasqyra Nr.10

FIROT E KARBURANTEVE GJATË KONSERVIMIT NË TEKNIKËN LUFTARAKE  
DHE SHPËRNDARJES ME PAKICË GJATË STËRVITJES NË TERREN

(Të zbatueshme vetëm për Ministrinë e Mbrojtjes Popullore)

a- Firot gjatë ruajtjes së karburanteve në fuçi e në kontinierë

<u>Emërtimi:</u>	<u>Kushtet e ruajtjes</u>	<u>Në përqindje në vit</u>
1. Bonzinë e të gjitha llojeve.....	Mbi tokë, deri..... Nën tokë, deri.....	0,06 0,03
2. Vajguri TS-1 otj...	Mbi tokë, deri.... Nën tokë, deri....	0,02 0,01
3. Gazoil e solar.....	Mbi tokë, deri.... Nën tokë, deri.....	0,01 0,005

b - Firot gjatë ruajtjes së karburantëve për periudhën e konservimit të teknikës luftarake

<u>Emërtimi:</u>	<u>Sezoni</u>	<u>Në përqindje të sasisë në muaj</u>
1. Benzinë e të gjitha llojeve.....	pranverë+verë, deri vjeshtë+dimër, deri	0,2 0,1
2. Vajguri TS-1 otj...	pranverë+verë, deri vjeshtë+dimër, deri	0,03 0,015
3. Gazoil e solar....	pranverë+verë, deri vjeshtë+dimër, deri	0,01 0,005

c - Firot gjatë shpërndarjes me pakicë të karburantëve gjatë stërvitjeve në kushte fushore

<u>Emërtimi:</u>	<u>Sezoni</u>	<u>Në përqindje të sasisë</u>
1. Bonzinë e të gjitha llojeve.....	pranverë+verë, deri vjeshtë+dimër, deri	0,12 0,1
2. Vajguri TS-1 otj....	pranverë+verë, deri vjeshtë+dimër, deri	0,025 0,015
3. Gazoil e solar.....	pranverë+verë, deri vjeshtë+dimër, deri	0,08 0,06